

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Unë nuk kam pasur kurrë frikë"/Adoleshentja u zhduk pa gjurmë, shoqja e priftit të rremë nën hetim pas 4 dekadash! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/une-nuk-kam-pasur-kurre-frike-adoleshentja-u-zhduk-pa-gj-urme-shoqja-e-priftit-te-rreme-nen-hetim-pas-4-dekadash/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:45:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:11:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d603a355203f84a0c0e5d6f8d36044034c062ab5aac33d478621c3ed811038c
TEKSTI	9d0644e99bc33dba51842582149d82b7ce4af68cd424d9e95820d2b3a0487523
PAMJA	01bbada30671c5e36d1fc25c2b148fec29d583b795a85db88dd7dee929682cb7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dab23181c62c5846279ace2626f36c97f7581c79da7ddda488d7ba7d5e1e1f51
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/dab23181c62c5846279ace2626f36c97f7581c79da7ddda488d7ba7d5e1e1f51

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

“Unë nuk kam pasur kurrë frikë”/Adoleshentja u zhduk pa gjurmë, shoqja e priftit të rremë nën hetim pas 4 dekadash!



Marisa Karabeci
26 Shtator 2026



Pas Laura Casagrande dhe Marco Fassoni Accetti, tashmë del në skenë emri i një personi të tretë nën hetim në hetimin e ri të Prokurorisë së Romës për zhdukjen e Emanuela Orlandit.

Bëhet fjalë për Gabriella Boggiani, ish-shoqe e Accettit, e njohur për hetuesit për shkak të një telefonate që ajo kreu së bashku me fotografën dhe kineastin romak, në vitin 1983. Ajo tashmë është 70 vjeç.

“Po mësoj vetëm tani se jam nën hetim”, tha ajo përpara Komisionit parlamentar dypalësh të hetimit për zhdukjen e Mirella Gregorit dhe Emanuela Orlandit. Kjo deklaratë konfirmohet edhe nga burime pranë Prokurorisë. Gruaja rezultoi nën hetim në një dosje të ndryshme nga ajo e Accettit, ku dyshohet se janë përfshirë edhe persona të tjerë, të gjithë pjesë e rrethit të njohjeve të fotografit në atë kohë, i cili në të kaluarën e kishte pranuar vetë se ishte përfshirë në rrëmbimin e Emanuela Orlandit.

“Unë nuk kam pasur kurrë frikë”, tha Boggiani gjatë një seance me dyer të mbyllura. “Sigurisht, tani, pas asaj që është thënë këtu, unë nuk e dija se isha nën hetim dhe, disi, kam frikë.” Boggiani sqaroi më pas episodën për të cilin emri i saj ishte përmendur edhe në disa rindërtime mediatike, të cilat madje kishin bërë që ajo të konsiderohej si një bashkëpunëtore e dyshuar e Accettit. Sot, megjithatë, gruaja është distancuar prej tij, duke e përshkruar si një tip “të çuditshëm, pak të marrë”, me të cilin nuk ka pasur më kontakte pas një njohjeje të rastësishme më shumë se 40 vjet më parë.

“Një ditë Accetti më tha: hajde, hajde, bëje këtë shaka – tregoje këtë telefonatë”, ka rrëfyer ajo. “E bëra. Ishim në një kabinë telefonike në lagjen Africano”, në Romë, “por pa menduar se kishte diçka të çuditshme. Unë nuk e dija as se kush ishte ky emër, kjo Orlandi. Ende nuk kishte ndodhur asgjë.

Ai me tha: Inuaj se ne e dime se ku ngodnet Emanuelea Orlandi, une kaq, moaron. E pyetur me tej nga anëtarët e komisionit, ajo shtoi: “Konfirmoj se kam bërë një telefonatë, jo se kam lexuar një komunikatë”, duke iu referuar pretendimit se gjatë asaj telefonate ishte lexuar një komunikatë ku kërkohej shkëmbimi i Emanuelës me terroristin turk Ali Agca.

Prej një kohe të gjatë, si Komisioni, ashtu edhe Prokuroria po përpiqen të rishqyrtojnë me kujdes episode dhe aspekte që në të kaluarën nuk janë hetuar në thellësi dhe që lidhen me Accettin, i cili tashmë është nën hetim në bashkëpunim me persona ende të paidentifikuar për rrëmbimin me qëllim zhvatjeje të Mirella Gregorit dhe Emanuela Orlandit.

Përveç rastit të 15-vjeçares, shtetase e Vatikanit, vëmendja është zgjeruar edhe te vdekja e 13-vjeçarit José Garramon, i cili u gjet i pajetë në dhjetor të të njëjtit vit në pyllin me pisha të Castel Porziano. Pikërisht Accetti e përplasi me automjetin dhe më pas u dënua përfundimisht vetëm për vrasje nga pakujdesia, ndërsa sot hetuesit po shqyrtojnë mundësinë që të mos ketë qenë një aksident i thjeshtë.

Në lidhje me këtë çështje, javën e kaluar u dëgjua nga Komisioni edhe nëna e Josés, Maria Laura Bulanti, e cila e njohu Accettin si “priftin e rremë” që ishte paraqitur në shtëpinë e saj pak para zhdukjes së të birit. Ndërkohë, Njësia e Hetimeve Shkencore e Karabinierëve (RIS) po kryen ekspertizë të reja gjenetike mbi flautën që Accetti i dorëzoi Prokurorisë në kohën kur pranoi vetë se ishte i përfshirë në zhdukjen e Emanuela Orlandit. Tashmë priten me interes rezultatet e këtyre analizave.



“Vatican Girl”, seriali që po shkakton makthe te njerëzit!



“Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe...”? Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



E reja vjen me një njoftim interesant: “Kërkoj një burrë me mbiemrin tim...”



Nations League, Kosova debuton me fitore!



Italia ndalon burkën në shkollë/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjallën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!



Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së “Dardanëve”!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!



Sa kalori digjen gjatë vërtetë seksit?!



“Zemra ndalet për gjysmë ore...”/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon çfarë ndodh gjatë operacionit: Pacientët kanë frikë!



Melatonina apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Të njëjtat vargje të përsëriten gjithë ditën? Ja pse një këngë mund të të “ngecë” në kokë...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!




“Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe...”/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?




A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballlet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura...



“Më bezdis përndjekja...”/Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

Kontaktoni
Marketing
Frekuenca
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.